

Njohuritë, Qëndrimet dhe Praktikat e të Rinjve lidhur me Trafikimin e Qenieve Njerëzore, në Katër Rajone në Shqipëri

PËRMBLEDHJE E GJETJEVE

Anketa e valës së parë



DHJETOR 2020

Deanna Davy,

Autore, Konsulente ndërkombëtare
për UNICEF në Shqipëri

Blerina Metanaj,

Autore, IDRA Shqipëri

Spontan Creative Media,

Kompania e Dizajnit

Ky dokument u përgatit në kuadrin e Programit “**Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në dhe nga Shqipëria**”, zbatuar nga një koalicion prej gjashtë organizatash lokale dhe ndërkombëtare: UNICEF-i në Shqipëri, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Terre des Homme, Tjetër Vizion, Vatra dhe Të Ndryshëm dhe të Barabartë.

Ky dokument u financua nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, gjithsesi pikëpamjet e shprehura në të nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikat zyrtare të UNICEF-it apo Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Lexuesit inkurajohen të përdorin materiale nga ky botim. Si zotërues i të drejtave të autorit, UNICEF-i në Shqipëri kërkon citimin përkatës dhe një kopje të botimit.

Citimi i rekomanduar për publikimin është:

Davy, C., Metanaj B., (2020). *Raporti “Njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në 4 rajone të Shqipëri – Anketa e valës së parë”*. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar / IDRA / UNICEF-i në Shqipëri.

Për informacione të mëtejshme ju lutemi kontaktoni:

Zyrën e UNICEF-it në Shqipëri
Rruga “Skënderbej”, Godina e OKB-së, kati i tretë
Tiranë, Shqipëri
Nr. i telefonit: +355 4 45 48 400
Email: tirana@unicef.org

Mirënjohje

Autorët e këtij raporti duan të falenderojnë Elda Denaj dhe David Gvineria, si dhe ekipin e UNICEF-it: Edina Kozma, Sonila Pema, Ornela Palushaj, Mersila Ballo, Eris Kasmi, Anila Miria, Alketa Zazo, Sergiu Tomsa dhe Phenny Kakama për mbështetjen e tyre teknike gjatë procesit.

Falenderime të singerta shkojnë për anëtarët e “Grupit Referues” të këtij studimi të cilët udhëhoqën procesin nën drejtimin e SH.T. Duncan Norman, Ambasador i Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri dhe Roberto De Bernardi, përfaqësues i UNICEF-it në Shqipëri, dhe këshillimit nga Znj. Silvana Banushi, Drejtore e Përgjithshme në Ministrinë e Brendshme.

Vlerësojmë gjithashtu mbështetjen e dhënë nga Znj. Harriet Morgan, oficerë për punët e brendshme dhe drejtësinë në Ambasadën Britanike, dhe Znj. Erjola Foto, menaxhere programi për skllavërinë moderne në Ambasadën Britanike.

Mirënjohje e veçantë shkon për anketuesit dhe ekipin e kompanisë IDRA, të cilët kryen intervistat në terren për këtë studim.

Falenderime të singerta shkojnë për të rinjtë Shqiptarë të cilët u përgjigjën pyetjeve – pa kohën dhe kontributin e tyre ky raport nuk do të ishte mundësuar.


Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në dhe nga Shqipëria

Me financim nga Zyra Qendrore e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, UNICEF-i në Shqipëri dhe partnerët e tij po zbatojnë një program, që do të kontribuojë në uljen e numrit të trafikimit të qenieve njerëzore në/dhe nga Shqipëria. Programi bën bashkë nisma të ndryshme për të forcuar parandalimin dhe mbrojtjen nga trafikimi i qenieve njerëzore dhe më pas intensifikon këto përpjekje, duke u fokusuar tek ndryshimi që mund të ndodhë për të sjellë një ndikim afatgjatë dhe të qëndrueshëm. Në planin afatgjatë, këto ndërhyrje duhet të plotësohen me zbatimin e një qasjeje progresive për të adresuar shkaqet bazë të trafikimit të qenieve njerëzore, nëpërmjet angazhimit afatgjatë të qeverisë, shoqërisë civile dhe komuniteteve vendore, nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë me individët, familjet dhe komunitetet në zonat e rrezikuara të Shqipërisë.



Komunikimin strategjik të bazuar mbi të dhëna, që sjellin ndryshim pozitiv tek individët, familjet, komunitetet dhe shërbim-ofruesit;

Modele ri-integrimit të qëndrueshme dhe të bazuara në të drejtat për viktimat dhe grupet në rrezik;



Drejtësia e orientuar ndaj viktimave, zbatimi efikas i ligjit dhe ndjekja penale;

Zgjidhjet komunitare me akses në shërbimet sociale, që ulin cenueshmërinë dhe çojnë drejt ri-integrimit të grupeve më në rrezik nga trafikimi.



HYRJJE

Shqipëria njihet si një vendburim për trafikimin e qenieve njerëzore. Përmes rrjeteve të organizuara kriminale, shqiptarët trafikohen shpesh drejt Italisë, Greqisë, Mbretërisë së Bashkuar, Suedisë, Gjermanisë dhe Zvicrës. Të rriturit dhe fëmijët shqiptarë trafikohen për punë dhe/ose shfrytëzim seksual në këto dhe në vende të tjera destinacioni. Ka gjithashtu raste të trafikimit nga Shqipëria drejt Kosovës, sidomos të fëmijëve romë, që detyrohen shpesh nga familjet e tyre të lypin. Trafikimi brenda vendit u kthye në një fenomen të dukshëm në Shqipëri pas vitit 2004, ku shumë viktima u trafikuan nga zonat rurale drejt atyre urbane të vendit. Ndër viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri, vihet re një përqindje e madhe e fëmijëve dhe të rinjve. Të dhënat nga organizatat, që punojnë në terren nxjerrin në pah se shumica e viktimave vijnë nga familjet e varfra, familjet e pastreha dhe ato me nivel të ulët arsimor. Për fëmijët dhe të rinjtë, që trafikohen, faktorët e rrezikut janë të lidhur kryesisht me familjen, si për shembull: mungesa e marrëdhënieve të shëndetshme në familje, shpërbërja e familjes, braktisja ose ndarja e familjes për shkak të migracionit, etj. Në thelb, si pasojë e këtyre kushteve, fëmijëve dhe të rinjve u mungojnë rrjetet e rëndësishme të sigurisë dhe mbrojtjes.

Ndërkohë që njohim faktin se të rinjtë shqiptarë janë të cenueshëm nga fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore, ka mungesë të dhënash për nivelin e njohurive dhe qëndrimeve të të rinjve lidhur me fenomenin në Shqipëri, si dhe praktikave të tyre lidhur me këtë fenomen. Vetëm dy studime në 5 vitet e fundit trajtojnë njohuritë dhe ndërgjegjësimin rreth trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri. Nga këto studime, ne kuptojmë se: të rriturit shqiptarë kanë më shumë dijeni rreth trafikimit për qëllime seksuale sesa rreth trafikimit për qëllime të shfrytëzimit të punës së detyruar; mbi gjysma e të rriturve shqiptarë mendojnë se trafikimi i qenieve njerëzore është një problem serioz, i cili lidhet kryesisht me gratë dhe fëmijët; shumë persona nuk dinë se si mund t'i ndihmojnë viktimat e mundshme. Asnjë prej këtyre studimeve nuk i ka adresuar njohuritë, që kanë të rinjtë lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore apo qëndrimet dhe praktikat e tyre lidhur me fenomenin. Studimi i prezantuar në këtë raport, i cili shqyrton këtë çështje, synon të mbushë këtë boshllëk të rëndësishëm. Ai realizohet në kuadër të Programit "Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në dhe nga Shqipëria". Rezultatet e tij do të jenë të dobishme për UNICEF-in në Shqipëri dhe partnerët e tij, qeverinë dhe shoqërinë civile në vend, si dhe për akademikët dhe politikëbërësit, që punojnë në këtë fushë në vend dhe në mbarë botën.

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Nëpërmjet kësaj ankete synohet të kuptohet dhe eksploroheh niveli i njohurive të të rinjve, qëndrimeve dhe praktikave të tyre lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në qarqet Tiranë, Shkodër, Dibër dhe Kukës. Qarqet e përzgjedhura janë të njohura për numrin e lartë të trafikimit të qenieve njerëzore brenda dhe jashtë vendit.

Ky studim ndahet në dy pjesë: (1) anketa e valës së parë dhe (2) anketa e valës së dytë. Qëllimi i anketës të valës së parë është njohja e nivelit të njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në katër qarqet e Shqipërisë dhe njohja e kanaleve të komunikimit që ata përdorin rregullisht për të mësuar rreth çështjeve sociale, duke përfshirë edhe trafikimin e qenieve njerëzore. Të dhënat e valës së parë do të përdoren për të mbështetur hartimin e strategjive të komunikimit, që do të zbatohen nga UNICEF-i në Shqipëri dhe partnerët e tij në të katërt qarqet e projektit. Pas zbatimit të strategjisë së komunikimit, do të zhvillohet një anketa e valës së dytë në të njëjtat zona. Ajo do të masë ndryshimet në njohuritë, qëndrimet dhe praktikën e synuara lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri, si dhe do të vlerësojë se cilat formate dhe mesazhe rreth trafikimit të qenieve njerëzore sjellin ndryshime pozitive të njohuritë, qëndrimet dhe praktikën e të rinjve lidhur me fenomenin.

OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Të vlerësojë njohuritë rreth:

- Asaj çfarë nënkuptohet me termin trafikimi i qenieve njerëzore;
- Vendit ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore;
- Llojeve të shfrytëzimit;
- Grupeve më të rrezikuara;
- Kushteve, që mund të çojnë drejt trafikimit të qenieve njerëzore;
- Metodave të rekrutimit dhe trafikantëve të qenieve njerëzore;
- Mënyrave për të mbështetur rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore;
- Shërbimeve mbështetëse në dispozicion të viktimave.

Të vlerësojë qëndrimet ndaj:

- Shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore;
- Nivelit të mbështetjes që shprehin të rinjtë ndaj viktimave;
- Masave të efektshme parandaluese.

Të vlerësojë praktikën:

- Nëse dhe si, të rinjtë do të mësojnë më shumë rreth trafikimit të qenieve njerëzore dhe të angazhoheshin në aktivitete kundër fenomenit.

METODOLOGJIA

Të dhënat u mblodhën nëpërmjet anketave ballë për ballë me të rinj shqiptarë përfshirë të rinj romë në katër qarqet e vendit: Tiranë, Shkodër, Kukës dhe Dibër. Anketat u zhvilluan me persona të grupmoshës 15-29 vjeç gjatë muajit gusht 2020. Në total u zhvilluan 1537 anketa. Familjet u përzgjedhën në mënyrë rastësore dhe vetëm një person për familje i grupmoshës 15-29 vjeç u lejua të merrte pjesë në intervistë. Intervistat u zhvilluan me anë të tabletave elektronike dhe çdo intervistë zgjati deri në 20 minuta.

GJETJET NGA ANKETA E VALËS SË PARË

Kur analizojmë rezultatet e anketës, kundrejt informacionit që dimë rreth rasteve të trafikimit në Shqipëri dhe në botë, duket qartë se njohuritë rreth trafikimit të qenieve njerëzore tek të rinjtë shqiptarë të anketuar janë të larta në disa aspekte, por ka vend për të përforcuar njohuritë lidhur me: llojet e shfrytëzimit; vendet ku trafikimi i qenieve njerëzore ndodh; personat më të rrezikuar; metodat e rekrutimit; mënyrat e raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore; shërbimet mbështetëse në dispozicion për viktimat.

Në pjesën më të madhe, qëndrimet e të rinjve të anketuar lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore janë pozitive. Shumica e të anketuarve janë të shqetësuar për trafikimin e qenieve njerëzore; shprehin mbështetje ndaj viktimave dhe besojnë se viktimat duhet të marrin shërbime mbështetëse; dhe kanë

qëndrime pozitive lidhur me përgjigjen e agjencive ligjzbatuese ndaj trafikimit të qenieve njerëzore. Megjithatë, ka vend për t'i përmirësuar këto qëndrime, veçanërisht tek të rinjtë e grupmoshës 15-17 vjeç lidhur me shqetësimin, që ata shprehin për trafikimin e qenieve njerëzore dhe qëndrimet mbështetëse ndaj viktimave të trafikimit.

Kur analizojmë rezultatet e anketës lidhur me praktikën e të rinjve është e qartë se të rinjtë e anketuar, aktualisht, do të donin të mësonin më shumë rreth trafikimit të qenieve njerëzore dhe të angazhoheshin në aktivitete kundër fenomenit. Interesi për angazhim shprehet përmes një numri të vogël kanalesh komunikimi, konkretisht përmes televizionit, medias sociale dhe portaleve online të lajmeve.

NJOHURITË RRETH TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

1 Njohuri se çfarë nënkupton trafikimi i qenieve njerëzore

47%

Pjesa më e madhe e të rinjve të anketuar e identifikojnë trafikimin e qenieve njerëzore si një çështje, që i përket të drejtave të njeriut.

22%

e të rinjve të anketuar e identifikojnë trafikimin e qenieve njerëzore si krim dhe akt të paligjshëm.

10%

besojnë se trafikimi i qenieve njerëzore është një çështje e lidhur me migracionin.

Në tërësi, njohuritë e të rinjve të anketuar rreth faktit se çfarë nënkupton trafikimi i qenieve njerëzore janë të mira. Megjithatë të rinjtë e anketuar nuk janë në gjendje ta përkufizojnë saktë termin "trafikim i qenieve njerëzore", ata e kuptojnë se është një çështje, që lidhet me të drejtat e njeriut, ose krim, apo çështje lidhur me migracionin e parregullt.

2 Njohuri se ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore



Më shumë se gjysma e të rinjve të anketuar mendojnë se trafikimi i shqiptarëve drejt vendeve të huaja është një problem shumë serioz ose serioz.



Vetëm një në tre të rinj të anketuar mendojnë se trafikimi i qenieve njerëzore brenda vendit është çështje serioze në Shqipëri.

Kjo do të thotë se të rinjtë e anketuar kanë më pak dijeni për praninë e trafikimit të qenieve njerëzore brenda territorit Shqiptar sesa për trafikimin e shqiptarëve në vendet e huaja.

70%

Mbi 70 për qind e të rinjve të anketuar mendojnë se trafikimi i qenieve njerëzore në komunitetin e tyre është një çështje disi serioze ose aspak serioze.

Në disa bashki, njohuritë se trafikimi i qenieve njerëzore mund të ndodhë në komunitetin vendas janë jashtëzakonisht të pakta.

Të rinjtë romë treguan njohuri më të mira sesa mesatarja e përgjithshme në përgjigjet ndaj të trija pyetjeve të anketës mbi ku ndodh trafikimi i qenieve njerëzore.

Të rinjtë e grupmoshës 18-29 vjeç kanë njohuri më të mira se ku mund të ndodhë trafikimi i qenieve njerëzore krahasuar me ata të grupmoshës 15-17 vjeç.



Të rinjtë me arsim të lartë treguan njohuri më të mira, se trafikimi i qenieve njerëzore ndodh në Shqipëri dhe në komunitetin e tyre, krahasuar me të rinjtë me nivel më të ulët arsimor.



Në krahasim me të rinjtë, të rejat e anketuara theksojnë disi më fort faktin se trafikimi i qenieve njerëzore është një problem jashtëzakonisht serioz ose shumë serioz në vendet fqinje dhe në Shqipëri.

Po ashtu, të rinjtë në zonat urbane treguan njohuri më të mira, se trafikimi i qenieve njerëzore ndodh në komunitetin e tyre vendas, krahasuar me të rinjtë në zonat rurale.

3 Njohuri rreth llojeve të shfrytëzimit, që ndodh në Shqipëri dhe në vende të huaja

Shumica e të rinjve shqiptarë të anketuar kanë dijeni për format më të përhapura të shfrytëzimit, si trafikimi për shfrytëzim seksual dhe punë të detyruar. **Megjithatë, ata kanë më pak dijeni për llojet e tjera të shfrytëzimit, si trafikimi për martesë në moshë të hershme, pornografia me fëmijë,¹ dhe trafikimi i organeve.** Për sa u përket pyetjeve rreth llojeve të shfrytëzimit, që ndodhin në Shqipëri dhe në vende të huaja, nuk kishte dallim të ndjeshëm ndërmjet përgjigjeve të të rinjve dhe të rejave, ndërmjet grupmoshave të ndryshme, niveleve arsimore dhe ndërmjet të rinjve të zonave urbane dhe rurale. Të rinjtë e anketuar romë demonstuan disi më pak njohuri sesa të rinjtë e tjerë të anketuar rreth llojeve të ndryshme të shfrytëzimit, që ndodh jashtë Shqipërisë (në vende të huaja).

LLOJET E SHFRYTEZIMIT MË PAK TË NJOHURA



MARTESË NË MOSHË TË HERSHME



PORNOGRAFIA ME FËMIJË



TRAFIKIMI I ORGANEVE

¹ Termi "pornografi me fëmijë" u përdor në pyetësin e valës së parë. Duke pranuar se termit "abuzim seksual i fëmijëve" dhe "materiale të shfrytëzimit seksual të fëmijëve" konsiderohen nga komuniteti ndërkombëtar si më pak stigmatizues për viktimat, në valën e dytë do të përdoret terminologji tjetër.

4 Njohuri se kush është i rrezikuar nga trafikimi i qenieve njerëzore

Shumica e të rinjve të anketuar mendojnë se grupi më i rrezikuar për trafikim të qenieve njerëzore janë vajzat nën moshën 18 vjeç.

80%

e të rinjve të anketuar mendojnë se vajzat janë "jashtëzakonisht" ose "shumë" të rrezikuara për t'u trafikuar.

Shumica e të rinjve shqiptarë mendojnë se burrat dhe djemtë kanë më pak gjasa të trafikohen.

10%

e të gjithë të rinjve të anketuar mendojnë se burrat janë të rrezikuar nga trafikimi i qenieve njerëzore.

Në nivel bashkie kishte ndryshim të ndjeshëm të përgjigjeve lidhur me njohuritë se burrat dhe djemtë mund të trafikohen. Për shembull, 67 për qind e të rinjve të anketuar në Kukës raportojnë se djemtë janë jashtëzakonisht të rrezikuar krahasuar me vetëm 8 për qind në Dibër. Të rinjtë me arsim të lartë kanë njohuri më të mira sesa të rinjtë e tjerë të anketuar se burrat dhe djemtë janë të rrezikuar nga fenomeni i trafikimit.

Njohuritë se pakicat kombëtare dhe banorët e zonave rurale janë të rrezikuar nga trafikimi i qenieve njerëzore janë mjaft të ulëta në disa zona. Për shembull, vetëm 34 për qind e të rinjve të anketuar në Dibër mendojnë se pakicat kombëtare janë të rrezikuara nga trafikimi dhe vetëm 29 për qind e të rinjve të anketuar në Dibër mendojnë se banorët e zonave rurale janë të rrezikuar nga trafikimi. 58 për qind e të rinjve romë të anketuar mendojnë se pakicat kombëtare janë jashtëzakonisht ose shumë të rrezikuara nga trafikimi i qenieve njerëzore.



Analiza e përgjigjeve të të rinjve, që jetojnë në zona rurale dhe urbane nxjerr në pah se shumica e të rinjve të anketuar në zonat rurale nuk mendojnë se janë në rrezik të konsiderueshëm për t'u trafikuar për shkak se jetojnë në një zonë rurale.

5 Njohuri rreth kushteve, që mund të çojnë drejt trafikimit të qenieve njerëzore



Të rinjtë e anketuar mendojnë se kushti kryesor, që sjell trafikimin e qenieve njerëzore është varfëria dhe se shumë nga kushtet e tjera dhe faktorët e cenueshmërisë nuk janë të rëndësishëm.

27%

Vetëm 27 për qind e të rinjve të anketuar e lidhin mungesën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor me rrezikun e trafikimit të qenieve njerëzore;

31%

mendojnë se mungesa e informacionit rreth migracionit të sigurt është e rëndësishme;

47%

mendojnë se presioni i familjes për të fituar para është një parakusht, që mund të çojë drejt trafikimit të qenieve njerëzore.

Të rinjtë e anketuar në zonat rurale, të rinjtë e anketuar romë dhe ata me nivel të ulët arsimor nuk e konsiderojnë mungesën e arsimimit si një nga kushtet më të rëndësishme, që mund të çojë drejt trafikimit të qenieve njerëzore. Po ashtu, për sa i përket "mungesës së informacionit rreth migracionit të sigurt" dhe "mungesës së informacionit mbi parandalimin, rreziqet dhe pasojat e trafikimit të qenieve njerëzore", të rinjtë romë dhe ata me nivel arsimor bazë kanë njohuri më të ulëta se këto kushte mund të çojnë drejt trafikimit të qenieve njerëzore krahasuar me të rinjtë e tjerë të anketuar.

6 Njohuri rreth metodave të rekrutimit të përdorura nga trafikantët dhe rreth trafikantëve të qenieve njerëzore

Njohuritë rreth metodave të rekrutimit të përdorura nga trafikantët janë të shëndosha. Shumica e të rinjve të anketuar janë përgjigjur me "e vërtetë", ndaj të gjitha alternativave të dhëna për pyetjen rreth metodave të rekrutimit dhe trafikantëve të qenieve njerëzore, konkretisht:



interneti mund të përdoret për të rekrutuar viktime;



trafikantët janë pjesë e grupeve të organizuara kriminale;



i dashuri ose e dashura mund të jenë trafikantë të qenieve njerëzore;



shokët mund të jenë trafikantë të qenieve njerëzore.



Megjithatë, vetëm disa prej të anketuarve u përgjigjën "e vërtetë", ndaj alternativës se "familjarët mund të jenë trafikantë të qenieve njerëzore".


Të rejtat e anketuara kanë njohuri më të mira sesa të rinjtë lidhur me metodat e rekrutimit dhe se kush mund të jetë trafikant i qenieve njerëzore.

Të rinjtë e grupmoshës 25-29 vjeç kanë njohuri më të mira sesa të rinjtë e grupmoshave më të vogla lidhur me metodat e rekrutimit dhe se kush mund të jetë trafikant i qenieve njerëzore.

7 Njohuri rreth mënyrave për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore

Të rinjtë e anketuar kanë njohuri të raportimit të rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore në polici, por kanë më pak dijeni për linja të tjera të raportimit.

Mënyrat më të njohura të raportimit të trafikimit të qenieve njerëzore ishin: Rajoni i Policisë (87%) dhe linja telefonike e Policisë 129 (60%). Alternativa e "linjës telefonike të Policisë 129" ishte më e përzgjedhur në Dibër, me 72 për qind të të rinjve të anketuar, që e përzgjedhën atë krahasuar me 56 për qind në Tiranë. Pas rajonit të Policisë dhe linjës telefonike të Policisë 129, mënyra tjetër më e njohur ishte "mësuesi, psikologu ose profesionistë të tjerë në shkollë" me rreth 43 për qind të të rinjve të anketuar, që përzgjedhën këtë alternativë. **Këto përgjigje tregojnë se të rinjtë shqiptarë ose kanë shumë besim te agjencitë ligjzbatuese dhe tek personeli arsimor, ose të paktën i konsiderojnë këto dy sisteme si më të përshtatshmet për raportim të rasteve të trafikimit.**



Njohuritë e të rinjve romë të anketuar rreth mënyrave të raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore janë shumë të ulëta. 12 për qind e të rinjve romë të anketuar u përgjigjën me alternativën "nuk e di", për faktin se kë të kontaktojnë për të raportuar raste të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore, krahasuar me vetëm 1 deri në 2 për qind të të rinjve të anketuar në të katër qarqet. Të rejat e anketuara kanë më shumë njohuri rreth mënyrave të raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore sesa të rinjtë, me përjashtim të linjës së Policisë 129 (62 për qind e të rinjve të anketuar krahasuar me 58 për qind e të rejave të anketuara). Të rinjtë në zonat urbane kanë njohuri më të mira rreth raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore në Polici, ndërsa të rinjtë në zonat rurale kanë njohuri më të mira rreth linjës telefonike 129.



Megjithatë, shqetësues është fakti që 21 për qind e të rinjve romë të anketuar, u përgjigjën se nuk i konsiderojnë të rëndësishme asnjë prej alternativave të raportimit, çka tregon për një mungesë interesi nga ana e të rinjve romë për të raportuar rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore.

Kjo mund të interpretohet si mungesë besimi te agjencitë ligjzbatuese dhe aktorët e tjerë, ose si perceptim se këto agjenci dhe individë nuk do të marrin asnjë masë për të ndërhyrë në rastet e dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore.

8 Njohuri rreth shërbimeve mbështetëse në dispozicion për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore

Njohuritë rreth llojeve të ndryshme të mbështetjes në dispozicion për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore janë të ulëta ndër të rinjtë e anketuar.

41%

e të rinjve nuk kanë dijeni për format e mbështetjes, që janë në dispozicion në vend për viktimat e trafikimit.

Llojet e shërbimeve mbështetëse, të cilat ishin më të njohura janë: Mbështetja specifike nga Policia e Shtetit (23%) dhe mbështetja sociale nga organizatat jo fitim-prurëse (21%). Njohuritë rreth shërbimeve mbështetëse në dispozicion në vend për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore janë më të ulëta në Dibër, ku 55 për qind e të rinjve të anketuar nuk kanë dijeni për to. 46 për qind e të rinjve romë të anketuar nuk kanë njohuri për asnjë nga shërbimet mbështetëse në dispozicion të viktimave të trafikimit.



Njohuritë rreth llojit të mbështetjes në dispozicion për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore janë më të larta tek të rejat e anketuara sesa tek të rinjtë. Niveli i njohurive është më i lartë tek të rinjtë e anketuar të grupmoshës 18-24 vjeç sesa te grupmoshat e tjera. Të rinjtë me arsim të lartë kanë njohuri më të mira sesa të rinjtë me nivele më të ulëta arsimore.

62%

e të rinjve me arsim të ulët nuk ishin në dijeni të ndonjë lloji mbështetjeje në dispozicion të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore;

25%

krahasuar me 25 për qind të të rinjve të anketuar me arsim të lartë.

QËNDRIMET LIDHUR ME TRAFIKIMIN E QENIEVE NJERËZORE

1 Niveli i shqetësimit lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore

56%

e të rinjve të anketuar raportuan se ndiejnë jashtëzakonisht ose shumë shqetësim rreth trafikimit të qenieve njerëzore.

Shqetësimi është më i lartë në Tiranë me 69 për qind të të rinjve të anketuar, që raportuan se ndiejnë jashtëzakonisht ose shumë shqetësim rreth trafikimit të qenieve njerëzore, krahasuar me vetëm 37 për qind në Shkodër.

58%

e të rinjve të anketuar romë raportuan se ndiejnë jashtëzakonisht ose shumë shqetësim rreth trafikimit të qenieve njerëzore.

Të rejtat e anketuara ndiejnë më shumë shqetësim rreth trafikimit të qenieve njerëzore sesa të rinjtë e anketuar, përkatësisht me 66 për qind të të rejave të anketuara, që shprehin shqetësim kundrejt 45 për qind të të rinjve të anketuar. **Të rinjtë e grupmoshës 15-17 vjeç ndihen ndjeshëm më pak të shqetësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore sesa të rinjtë e grupmoshës 18-29 vjeç.** Të rinjtë e anketuar, që jetojnë në zona urbane ndiejnë më shumë shqetësim sesa ata të zonave rurale (përkatësisht 66% kundrejt 46%). Po ashtu, të rinjtë me arsim të lartë ndiejnë më shumë shqetësim krahasuar me ata me arsim bazë (68% kundrejt 40%).

2 Qëndrimet ndaj viktimave



Shumica (91%) e të rinjve të anketuar raportuan se janë "plotësisht dakord" ose "shumë dakord" që viktimave duhet t'iu ofrohet mbështetje. Vetëm 2 për qind e të rinjve të anketuar raportuan se janë "disi dakord" ose "aspak dakord" që viktimave duhet t'iu ofrohet mbështetje.

Kjo tregon se qëndrimet ndaj viktimave janë pozitive për faktin që të rinjtë e anketuar mendojnë se viktimave duhet t'iu ofrohen shërbime mbështetëse qeveritare dhe joqeveritare.

3 Qëndrimet ndaj parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore

Të rinjtë shqiptarë mendojnë se masat e agjencive ligjzbatuese janë masat më të efektshme për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe i japin më pak rëndësi faktorëve socio-ekonomikë, që i bëjnë personat më të cenueshëm ndaj trafikimit të qenieve njerëzore.

94%

e të rinjve të anketuar mendojnë se ndëshkimet më të rrepta për ata që dhunojnë gratë dhe vajzat, do të ishin jashtëzakonisht ose shumë të efektshme për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

93%

besojnë se miratimi i ndëshkimeve më të rrepta për trafikantët do të ishte jashtëzakonisht ose shumë i efektshëm.

Përgjigjet pozitive lidhur me ofrimin e mbështetjes për punësim dhe strehim dhe arsimim, si metoda për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, ishin më të ulëta sesa përgjigjet për alternativat "ndëshkim më i rreptë". Përgjigjet tregojnë se shumica e të rinjve të anketuar e shohin trafikimin e qenieve njerëzore si një çështje, që parandalohet më mirë përmes masave të rrepta të agjencive ligjzbatuese. Gjithashtu, përgjigjet tregojnë një qëndrim të fortë ndaj trafikantëve të qenieve njerëzore. Në krahasim me të rinjtë me arsim të ulët, ata me arsim të lartë besojnë më shumë për efektivitetin e të gjitha masave të pyetura për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

PRAKTIKAT DHE KANALET E KOMUNIKIMIT

1 Interesi për të mësuar më shumë rreth trafikimit të qenieve njerëzore dhe për t'u angazhuar në aktivitete kundër fenomenit

Të rinjtë e anketuar do të donin të mësonin më shumë rreth trafikimit të qenieve njerëzore dhe të angazhoheshin në aktivitete, që lidhen me të si: ndjekja e një filmi ose dokumentari rreth trafikimit të qenieve njerëzore (49% e të rinjve të anketuar raportuan se do të ishin "jashtëzakonisht" ose "shumë" të interesuar për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore sipas kësaj mënyre), dhe "raportimi i një rasti të mundshëm të trafikimit të qenieve njerëzore" (49%), si dhe "ndjekja e një programi investigativ në një kanal televiziv rreth trafikimit të qenieve njerëzore" (48%). Aktivitetet për të cilat të rinjtë treguan më pak interes ishin: "luajtja e një loje/kuizi në telefonin "smart" për trafikimin e qenieve njerëzore" (23%), "aktivizimi si vullnetar për një organizatë jo ftimi-prurëse" (28%) dhe "angazhimi në një fushatë vendore kundër trafikimit" (30%).

Të rinjtë e anketuar do të donin të mësonin më shumë rreth trafikimit të qenieve njerëzore dhe të angazhoheshin në aktivitete, që lidhen me të si:

Ndjekja e një filmi ose dokumentari rreth trafikimit të qenieve njerëzore

Raportimi i një rasti të mundshëm të trafikimit të qenieve njerëzore

Ndjekja e një programi investigativ në një kanal televiziv rreth trafikimit të qenieve njerëzore

49%

49%

48%

Të rejtat janë më të interesuara për t'u angazhuar në aktivitete sesa të rinjtë. Më shumë se gjysma e të rejave të anketuara raportuan se ishin "jashtëzakonisht" ose "shumë" të interesuara për të parë një program investigativ në televizion rreth trafikimit të qenieve njerëzore; për të parë një film ose dokumentar rreth trafikimit të qenieve njerëzore; për të kontaktuar ose raportuar diku për një rast të mundshëm të trafikimit të qenieve njerëzore; për të folur me familjen e tyre rreth trafikimit të qenieve njerëzore; ose për të lexuar një artikull rreth trafikimit të qenieve njerëzore në mediat sociale. Të rinjtë e grupmoshës 15-17 vjeç janë më pak të interesuar të angazhohen në aktivitete, që lidhen me trafikimin, sesa grupmoshat e tjera në shumicën e alternativave. Për aktivitetet "kontaktoj ose raportoj diku për një rast të mundshëm të trafikimit të qenieve njerëzore" dhe "angazhohem në një fushatë kundër trafikimit", më shumë interes për zhvillimin e tyre kanë të rinjtë e zonave urbane sesa ata të zonave rurale. Interesi për këto dy aktivitete është shumë më i madh ndër të rinjtë me arsim të lartë sesa tek ata me arsim të ulët.


2 Metodat e informimit rreth çështjeve sociale, duke përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore

Metodat më të përdorura për të mësuar rreth çështjeve sociale ishin: Televizioni (77%), i ndjekur nga Facebook (62%), Instagram (61%) dhe portalet online të lajmeve në aplikacione të ndryshme (30%). Të rinjtë e anketuar raportuan interes jashtëzakonisht të ulët ose aspak interes për të mësuar rreth çështjeve sociale nëpërmjet: grupeve fetare (0%); diskutimeve publike (0%); luajtjes së një loje apo kuizi në telefonin e tyre "smart" (1%); posterave (1%); angazhimit në organizata jo ftimi-prurëse (1%) ose universitete (2%); radios (2%); fletëpalosjeve (3%); punës (4%); grupit rinor (4%); dhe librave (6%). Shkolla shihet si një burim i rëndësishëm informacioni për grupmoshën 15-17 vjeç.

Të rinjtë e anketuar sugjerojnë se do të mësonin më shumë rreth trafikimit të qenieve njerëzore duke përdorur të njëjtat metoda, që ata përdorin për të mësuar rreth çështjeve të tjera sociale: Televizioni (73%), Instagram-i (55%), Facebook-u (54%), portalet online të lajmeve në aplikacione të ndryshme (31%), si dhe dokumentarët (26%) dhe filmat (24%). Të rinjtë e anketuar treguan shumë pak interes për të mësuar rreth trafikimit të qenieve njerëzore përmes alternativave të tjera të ofruara.

Në krahasim me të rinjtë e anketuar, të rejtat e anketuara përdorin televizionin si burim informacioni rreth çështjeve sociale dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Në krahasim me të rejtat, më shumë të rinjtë e anketuar përdorin median sociale, si Facebook dhe Instagram, si burim informacioni. Megjithatë, në përgjithësi, të rinjtë dhe të rejtat përdorin të njëjtat burime informacioni për të mësuar rreth çështjeve sociale dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

3 METODAT E INFORMIMIT QË PËRDOREN PËR ÇËSHTJE SOCIALE



3 METODAT E INFORMIMIT QË DUAN TË PËRDORIN PËR TË MËSUAR RRETH TRAFIKIMIT TË QËNIVE NJERËZORE



Të rinjtë me arsim të lartë janë më të interesuar sesa të rinjtë me arsim të ulët për të mësuar rreth çështjeve sociale, duke përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore, përmes portaleve online të lajmeve, dhe dokumentarëve. Të rinjtë me arsim të ulët dhe të mesëm janë më të interesuar për të mësuar rreth çështjeve sociale dhe trafikimit të qenieve njerëzore nëpërmjet televizionit, shokëve, familjes dhe shkollës sesa të rinjtë me arsim të lartë.

Gjetjet nga anketa e valës së parë nxjerrin në pah fusha ku nevojitet përfundimi i njohurive të rinjve shqiptarë lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, çka mund të rezultojë në ndryshimin e qëndrimeve dhe rrjedhimisht edhe të praktikave. Prandaj, përgjigjja e Programit duhet të marrë në konsideratë:

- Vëmendjen ndaj të rinjve, që jetojnë në zona rurale, të thella ose të populluara me pakicë etnike (romë), pasi ky grup, në krahasim me gjithë të tjerët, ka më pak njohuri rreth trafikimit të qenieve njerëzore, është më pak vigjilent ndaj rreziqeve dhe shfaq një shkallë të ulët empatie ndaj viktimave;
- Rivlerësimin/rimendimin në masën e mundshme të ndërhyrjeve të planifikuara, që përdorin kryesisht ato forma/formate komunikimi (p.sh. postera), të cilat, sipas evidencave të mbledhura kanë efekt shumë të kufizuar;
- Përfundimin e njohurive se trafikimi i qenieve njerëzore mund të ndodhë kudo, duke përfshirë Shqipërinë dhe komunitetet vendase;
- Përfundimin e njohurive rreth llojeve të ndryshme të shfrytëzimit, që mund të ndodhin në vende të huaja dhe në Shqipëri, si pornografia me fëmijë,² dhe martesat në moshë të hershme;
- Gjetjen e mënyrës për të adresuar përplasjen e stereotipeve të fortë rreth të qenit “burrë/ mashkull” dhe realitetit se djemtë dhe burrat janë dhe mund të jenë viktimat të trafikimit;
- Rritjen e ndërgjegjësimit se pakicat kombëtare dhe banorët e zonave rurale janë shumë të rrezikuar nga trafikimi i qenieve njerëzore;
- Gjetjen e mënyrave për shpjeguar më mirë korrelacionin ndërmjet faktorëve të ndryshëm, përveç varfërisë, dhe fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore;
- Gjetjen e mënyrave për të rritur ndërgjegjësimin se kushdo mund të jetë trafikant i qenieve njerëzore;
- Përfundimin e njohurive lidhur me masat, që janë të rëndësishme për reduktimin e cenueshmërive dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, si punësimi, strehimi dhe mbështetja mjekësore;
- Përfundimin e njohurive mbi mënyrat e raportimit të trafikimit të qenieve njerëzore (përveçse në polici), dhe mbi shërbimet mbështetëse të disponueshme për viktimat (përveç mbështetjes nga policia dhe mbështetjes së përgjithshme nga organizatat jo ftimi-prurëse).
- Ndryshimin e qëndrimeve (empati ndaj viktimave) rreth të drejtës së viktimave për të marrë shërbime mbështetëse dhe rëndësisë së marrjes së këtyre shërbimeve për të reduktuar rrezikun e trafikimit dhe ciklet e ritrafikimit.
- Ndryshimin e qëndrimeve të rinjve rreth përfshirjes në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Një hap i parë i rëndësishëm do të ishte edukimi i të rinjve shqiptarë rreth mundësive të disponueshme për ta në komunitetin e tyre vendas. Përpara ndërmarrjes së këtij hapi, mund të jetë e nevojshme që fillimisht të zhvillohen aktivitete kundër trafikimit të qenieve njerëzore në zona të ndryshme të vendit.

Këto mund të arrihen përmes hartimit dhe zbatimit të strategjive të synuara të komunikimit, theksimi i tyre në median vizuale dhe sociale, portalet elektronike të lajmeve dhe përmes shkollës, me synim përfundimin e njohurive rreth trafikimit të qenieve njerëzore dhe reduktimit të cenueshmërisë së të rinjve nga fenomeni. Në planin afatgjatë, strategjitë e komunikimit mund të ndryshojnë njohuritë, qëndrimet dhe praktikat e të rinjve lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, dhe së fundi, mund të reduktojnë prevalencën e trafikimit të qenieve njerëzore në dhe nga Shqipëria.

Së fundi, gjetjet e anketës së valës së parë identifikojnë shumë fusha ku nevojiten kërkime në të ardhmen, duke përfshirë, por sigurisht pa u kufizuar në:

- Eksplorimin e arsyeve për të cilat të rinjtë mendojnë se njerëzit trafikohen më shpesh në vende të huaja sesa brenda vendit të tyre dhe, nëse ka një lidhje të rëndësishme ndërmjet njohurive rreth trafikimit të qenieve njerëzore (aty ku ai ndodh) dhe cenueshmërisë ndaj trafikimit të qenieve njerëzore.
- Të kuptuarit se përse të rinjtë mendojnë se gratë dhe vajzat janë më të rrezikuara nga trafikimi i qenieve njerëzore sesa djemtë dhe burrat dhe, përse janë të ulëta njohuritë se pakicat kombëtare dhe të rinjtë nga zonat rurale janë gjithashtu shumë të rrezikuar nga trafikimi i qenieve njerëzore.
- Eksplorimin e pyetjes mbi njohuritë e të rinjve rreth metodave të rekrutimit për trafikim të qenieve njerëzore dhe se kush mund të jetë trafikant i qenieve njerëzore. Për shembull, kërkimi në të ardhmen mund të synojë përmirësimin e të kuptuarit tonë se si dhe për çfarë arsye pjesëtarët e familjes së zgjeruar angazhohen në krime të trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe rreth perceptimeve të viktimave për familjarët si rekrutues dhe trafikantë të mundshëm.
- Të kuptuarit se përse njohuritë rreth mënyrave të raportimit të rasteve të dyshuara të trafikimit të qenieve njerëzore janë kaq të ulëta (përveç linjave të raportimit në polici), dhe përse njohuritë rreth shërbimeve mbështetëse të disponueshme për viktimat janë të ulëta, sidomos tek të rinjtë romë. Një kërkim i tillë do të ofronte perceptime të vlefshme rreth pengesave, me të cilat përballen pakicat kombëtare lidhur me aksesin në shërbime mbështetëse kyçe.



UNICEF Albania Country Office
Skenderbej Street,
UN House Bld, 3rd floor
Tirana, Albania

Telephone: +355 4 45 48 400
Email: tirana@unicef.org

© UNICEF Albania, Tirana
December 2020